

Bashkëpunimi mes institucioneve mbikëqyrëse të financimit politik në Kosovë dhe në Çeki

Ondřej Cakl, Eugen Cakolli

Historia e bashkëpunimit

Bashkëpunimi mes institucioneve mbikëqyrëse të financimit politik në Çeki dhe Kosovë ka filluar në vitin 2021, kur Drejtori i (atëherë) Zyrës për Regjistrimin e Partive Politike dhe Certifikim, kishte marrë pjesë në një aktivitet të shkëmbimit të përvojave, që ishte lehtësuar nga dy degë të Transparency International. Fillimisht, ishin organizuar mbledhje elektronike me qëllim të krahasimit të kornizave ligjore mbi bazën e të cilave funksionojnë institucionet mbikëqyrëse në të dyja vendet.

The collaboration between the Czech and Kosovar political finance oversight institutions started in 2021, when the head of Office for Registration, Certification and Financial Control of Political Entities (ORCFCE) participated in the experience exchange mediated by the two TI national chapters. At first on-line meetings were dedicated to the comparison of the legal framework within which the state oversight institutions operate in each country. Nga pjesëmarrësit prej të dyja zyrave, z. Yll Buleshkaj dhe Jan Outlý, ishte theksuar se pozita e ZRPPC-së ishte e kufizuar për shkak të varësisë së saj nga përbërja politike e KQZ-së si institucion kontrollues. Ata argumentuan se nuk është e lehtë të transferohet thjesht ekspertiza ndërmjet dy institucioneve, pasi që të dyja janë të pajisura me akte të brendshme, masa dhe kompetenca të ndryshme dhe përballen me presione të ndryshme. Bashkëpunimi ishte intensifikuar në nëntor të vitit 2021 kur anëtarët e të dyja zyrave, përfshirë anëtarët e KQZ-së së Republikës së Kosovës morën pjesë në një tryezë të rrumbullakët për shkëmbimin e përvojave në Prishtinë, duke rezultuar indirect edhe me përshpejtim të procedurave ligjvënëse për ligjin nr. 03 / L-174, i cili u miratua në vitin 2022.

“Rithemelimi” i Zyrës për Partitë Politike në Republikën e Kosovës

Sipas ligjit të ri për financimin e subjekteve politike, Zyrës për Regjistrimin, Certifikimin dhe Kontrollin Financiar të Subjekteve Politike (ZRCKFSP) i është dhënë një pavarësi më e madhe funksionale dhe burime shtesë në ushtrimin e kompetencave të saj ligjore të monitorimit dhe kontrollit financiar. Përgjegjësia për kontrollin e financave të subjekteve politike i është rikthyer KQZ-së, përkatësisht Zyrës, e cila me konkurs të hapur publik, do të **përzgjedhë auditorët e raporteve**

financiare duke përfshirë edhe ato të fushatave zgjedhore të subjekteve politike. **Zyra do të jetë instanca përfundimtare për shqiptimin e sanksioneve financiare** në rast shkeljesh ligjore, pa cenuar zbatimin e ndonjë sanksioni penal apo sanksioni tjetër nga institucionet përgjegjëse.

Ligji i ri specifikon llojet e kontributeve që mund të pranojnë subjektet politike. Përkufizimi i ri i kontributeve përfshin përfitimet financiare dhe jofinanciare të subjekteve politike, pagesat e borxheve të tyre, përfitimet e tjera dhe shërbimet e ofruara subjekteve politike nën vlerën reale të tregut - të cilat përbëjnë risi dhe elementë thelbësorë për të mundësuar kontroll më efektiv të financimit politik. Fuqizimi i kompetencave mbikëqyrëse të ZRCFSKP në vitin 2022 çoi në përafrimin e dy institucioneve, ZRCFSKP dhe UDHPSH. Detyrat ligjore dhe struktura e tyre tani janë më të përafërta, por prapë se prapë të ndryshme. Ky konkluzion në fakt shërbeu si bazë për shkëmbim intensiv të përvojave ndërmjet zyrave në Pragë në vitin 2022, kur anëtarët e Zyrës Çeke u takuan me Kryetarin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, z. Kreshnik Radoniqi dhe përfaqësuesit e ZRCFSKP, znj. Mergita Kryeziu Hiseni dhe znj. Nita Mustafa.

Dallimet kryesore në strukturat dhe detyrimet ligjore të Zyrave

UDHPSH është organ i pavarur shtetëror. Ndërsa, ZRCFSKP funksionon brenda strukturës së Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Megjithatë, të dyja janë nominalisht të shkëputura nga ndikimet politike. Të dyja kryejnë mbikëqyrjen mbi fushatat zgjedhore, megjithatë Zyra Çeke mund të përdorë një gamë më të gjerë masash për të siguruar transparencën e fushatës politike (siç janë llogaritë e detyrueshme transparente të fushatës ose rregullimi i palëve të treta në fushata). Të dyja zyrat janë të obliguara të vlerësojnë raportet financiare të fushatave dhe raportet vjetore të partive dhe është interesante se këtu ZRCFSKP-ja ka kompetenca më të forta se homologët e tyre çekë. Derisa ZRCFSKP është e obliguar të përzgjedhë dhe vlerësojë autoritetin për kryerjen e auditimit të pavarur të raporteve, në Çeki janë vetë partitë politike ato që duhet të dorëzojnë raportet e tyre tashmë të audituara nga auditorë të pavarur. Zyra kontrollon vetëm pajtueshmërinë e tyre formale.

Mësimet e nxjerra nga takimi i Pragës në vitin 2022

Krahas interesit të tyre të përbashkët për kompetencat dhe përgjegjësitë e Zyrave përkatëse në lidhje me auditimet financiare, vëmendje iu kushtua automatizimit të raportimit, personelit të zyrave si dhe kërkesave të tyre në zhvillimin e një dialogu përmbajtësor mes palëve. Ky është një shembull i shkëmbimit të **praktikave të mira**, pasi KQZ-ja e u frymëzua për të krijuar një pozitë të zyrarit ligjor/avokatit në kuadër të stafit të ZRCFSKP-së.

Ne mund të theksojmë dy rryma kryesore të interesit që u shfaqën përgjatë diskutimeve. Së pari, Kryesuesi i KQZ-së është përgjegjës për procedurën e përzgjedhjes së drejtorit të ZRCFSKP. Kjo përzgjedhje kishte filluar për herë të parë në kohën e vizitës në Pragë. Prandaj, u diskutua detajisht **profili i përgjithshëm i drejtorit të Zyrës**. Edhe pse u potencua përvoja, historia, paanshmëria dhe

besimi i publikut, u theksuan edhe disa aspekte formale dhe ligjore të kësaj pozite. Korniza ligjore çeke dhe ajo kosovare kërkojnë një periudhë “ftohjeje politike” prej tri vitesh pas çdo ekspozimi politik përpara se kandidatët të mund të aplikojnë për pozitën e Drejtorit Ekzekutiv të Zyrës – e cila përbën një kriter mjaft të dobishëm për të ruajtur neutralitetin politik të drejtuesve të zyrave. Për më tepër, pala çeke theksoi rëndësinë e përgatitjes preliminare procedurale të punës së brendshme ligjore ndërmjet drejtuesit të Zyrës dhe personelit të saj. Përkufizimi i qartë i subordinimit, vendimmarrjes dhe përgjegjësisive mund të shmangin pengesat e mëvonshme në punën e Zyrës. Si rrjedhojë, pas kthimit nga Praga, KQZ-ja filloi një procedurë për përgatitjen e akteve nënligjore në lidhje me funksionimin e brendshëm të Zyrës, duke përfshirë definimin e lartësisë së gjobave për shkeljet e legjislacionit mbi financimin politik.



Anëtarët e institucioneve mbikëqyrëse të Kosovës dhe Çekisë, gjatë takimit në Pragë më 22 nëntor, 2022. Nga e majta: František Sivera, Jan Outlý, Jiří Navrátil, Tomáš Hudeček, Mergita Kryeziu Hiseni, Kreshnik Radoniqi dhe Nita Mustafa.

Së dyti, përfaqësuesit e KQZ-së shprehën interes të veçantë për **llogaritë transparente bankare të subjekteve politike**, të cilat shërbejnë si instrument i monitorimit të financimit të partive në Republikën Çeke. Pas fillimit të zbatimit të tyre në vitin 2016, aktorët politikë u mësuan shpejt me detyrimin e krijimit të disa raporteve të llogarive bankare online, të cilat janë të qasshme nga publiku në kohë reale, të cilat parashikohen të përdoren për lloje të caktuara të operacioneve financiare të partive politike dhe kandidatëve të tyre. Edhe pse përcaktimi i detyrimit për llogaritë transparente bankare është jashtë kompetencave të KQZ-së ose ZRCFSKP -së (si dhe jashtë kompetencave të homologëve të tyre çekë), një mjet i tillë potencialisht do të përmirësonte transparencën e financave politike në Kosovë.

Përmbledhje - Pikat e forta, dobësitë, mundësitë, rreziqet

Pas shkëmbimeve të suksesshme të Pragës dhe Prishtinës, mund të konkludojmë se **zyrat përkatëse ndërtuan lidhje të forta profesionale** bazuar në interesin e tyre autentik për kryerjen e detyrës së mbikëqyrjes së pavarur mbi financimin politik. Për më tepër, ka përvoja përkatëse për t'u shkëmbyer reciprokisht si dhe një interes i përbashkët për bashkëpunimin ndërkombëtar si mjete përmirësimi nga të dyja palët. Si përfundim, ka terren adekuat për zhvillimin e mëtutjeshëm të bashkëpunimit. Megjithatë, **nuk ka mbështetje për një bashkëpunim të tillë institucional** ndërmjet institucioneve të mbikëqyrjes shtetërore të financimit politik në Evropë. Kjo i bën praktikën e shkëmbimit në të ardhmen shumë më atraktiv. Bashkëpunimi i Zyrave bazohet në thirrjen e organizatave të shoqërisë civile nga të dy vendet, të cilat kanë shërbyer si lehtësues në këto shkëmbime. Mungesa e kornizës institucionale për një bashkëpunim të tillë i bën këto bashkëpunime të dobëta dhe të cenueshme ndaj zbehjes. Përveçse një pikë e dobët e bashkëpunimit aktual, kjo mund të jetë një kërcënim edhe për zhvillimin e tij në të ardhmen. Megjithatë, mbetet një gamë mjaft e gjerë mundësish për përmirësimin e funksionimit të të dyja Zyrave nëpërmjet shkëmbimeve studimore, praktikave, transferimeve të praktikave të mira dhe impulseve të legjislacionit nga një vend në tjetrin. Prandaj, degët e Transparency International do të vazhdojnë përforcimin e bashkëpunimit mes Zyrave në të ardhmen.

Zbatimi i këtij projekti mbështetet nga programi i Promovimit të Tranzicionit, i Ministrisë së Punëve të Jashtme të Republikës së Çekisë.